

Njoftimi për Privatësinë e faqes se internetit

(Përditësimi i fundit sipas kërkesave të ligjit nr 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Korrik 2025)

1. QËLLIMI I KËTIJ NJOFTIMI

1.1 Ky Njoftim për Privatësinë e faqes se Internetit ("Njoftimi") shpjegon se cilat të dhëna personale mblidhen kur vizitoni faqen tonë të internetit atlantik.al dhe si përpunohen këto të dhëna nga Atlantik Shoqeri Sigurimesh sha në cilësinë e kontrollues të të dhënave ("Atlantik shoqeri sigurimesh sha" ose "ne").

1.2 Ky Njoftim i drejtohet çdo vizitori të faqes sonë të internetit.

1.3 Ne përpunojmë të dhënat tuaja personale në përputhje me ligjet kombëtare të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave, ligji nr 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Ligji).

2. CILAT TË DHËNA PERSONALE MBLIDHEN DHE SI I PËRDORIM ATO

2.1 Kur përdorni faqen tonë të internetit, ne mund të përpunojmë ato të dhëna personale që ju na i jepni vullnetarisht (p.sh., nëpërmjet formularit tonë të kontaktit).

2.2 Megjithatë, ju mund të vizitoni faqen tonë të internetit pa na dhënë në mënyrë aktive informacione rreth jush. Në këtë rast, ne mbledhim disa të dhëna që shfletuesi juaj i transmeton serverit të faqes sonë të internetit (p.sh. skedarët e regjistrimit) si dhe të dhëna që mbledhim përmes përdorimit të cookies ose teknologjive të ngjashme.

2.3 Shpjegimet në vazhdim kanë për qëllim t'ju informojnë mbi mënyrat e ndryshme se si mund të mbledhim të dhëna personale rreth jush në faqen tonë të internetit dhe për qëllime të ligjshme për të cilat mund t'i përdorim ato.

2.4 Të dhënat personale që ju na i bëni të ditura në mënyrë aktive

2.4.1 Kur komunikoni në mënyrë aktive me ne nëpërmjet faqes tonë të internetit, ne përpunojmë ato të dhëna personale që ju na i jepni vullnetarisht. Në veçanti kjo lidhet me shërbimet tona të mëposhtme:

- Formularët e kontaktit:** Kur zgjidhni të na kontaktoni përmes formularit të kontaktit të ofruar në faqen tonë të internetit, të dhënat personale që na jepni (p.sh. emri, adresa e email-it, korrespondenca) do të përpunohen për qëllimin që tju përgjigjemi pyetjeve tuaja, përmbushjen e kërkesave tuaja ose për komunikim të tjera me ju.

Baza ligjore: Neni 7(1) b i Ligjit.

- Bulentini informues:** Nëse jeni abonuar në Bulentinin tonë përmes faqes sonë të internetit, të dhënat personale që na ofroni (p.sh. emri, adresa e email-it, data e lindjes, preferencat për produktet) do të përpunohen për qëllimin e dërgimit të bulentinit të kërkuar, përfshirë informacion të personalizuar mbi produktet tona dhe ofertat në dispozicion. Nëse nuk

dëshironi më të merrni Bulentinin, mund të ç regjistrohemi në çdo kohë duke klikuar në linkun përkatës në çdo Bulentin që merrni nga ne ose duke na dërguar kërkesën tuaj për tërheqje me email.

Baza ligjore: Neni 7(1) a i Ligjit– pëlqimi.

- **Llogaria e Përdoruesit:** Nëse keni regjistruar një llogari përdoruesi në faqen tonë të internetit, të dhënat personale që na ofroni vullnetarisht (p.sh. emri, adresa e email-it, data e lindjes, fjalëkalimi, kërkesat për produkte) do të përpunohen për qëllimin e ofrimit të aksesit në llogarinë tuaj të përdoruesit, t'ju mundësohet shkrimi i komenteve dhe dërgimin i ofertave të personalizuar për përmbajtjen.

Baza ligjore: Neni 7(1) b i Ligjit– përmbushja e kontratës.

- **Aplikimet për punë:** Kur zgjidhni të na kontaktoni për të aplikuar për mundësitë e punës të shpallura në faqen tonë të internetit, të dhënat personale që na ofroni (p.sh. emri, të dhënat e kontaktit, letra e aplikimit, CV, fotografia, certifikatat dhe referencat, etj.) do të përpunohen për qëllimi shqyrtimin e aplikimit tuaj dhe marrjen në konsideratë në procesin e rekrutimit për pozicionin vakant.

Baza ligjore: Neni 7(1) b– përmbushja e detyrave (parakontraktuale).

2.4.2 Disa nga të dhënat që kërkojmë në lidhje me shërbimet tona të mësipërme mund të shënohen si fusha të detyrueshme. Nuk jeni të detyruar t'i jepni këto të dhëna. Megjithatë, nëse nuk i jepni këto informacione, mund të mos jemi në gjendje të përpunojmë kërkesën tuaj ose t'ju ofrojmë shërbimet tona.

2.5 Skedarët e regjistrimit

2.5.1 Ju mund të vizitoni gjithashtu faqen tonë të internetit pa na dhënë në mënyrë aktive informacione për veten tuaj. Në këtë rast, ne mbledhim disa të dhëna që shfletuesi juaj i transmeton serverit të faqes sonë të internetit (p.sh. skedarët e regjistrimit).

2.5.2 Skedarët tanë të regjistrimit përmbajnë informacionet e mëposhtme: (i) data dhe koha e aksesimit të faqes sonë të internetit, (ii) tipi, versioni dhe cilësimet e shfletuesit tuaj të internetit, (iii) sistemi juaj operativ dhe ofruesi juaj i shërbimit të internetit, (iv) faqet dhe skedarët e kërkuar, (v) faqja e internetit e përdorur para se të vizitonit faqen tonë të internetit, si dhe (vi) adresa juaj IP. Adresa IP është një numër specifik i caktuar kompjuterit tuaj që mundëson që pajisja juaj të komunikojë në një rrjet duke përdorur Protokollin e Internetit (IP). Adresat IP mund të konsiderohen si të dhëna personale pasi ato teknikisht mundësojnë identifikimin e përdoruesit në rrethana të caktuara.

2.5.3 Përpunimi i skedarëve të regjistrimit është i nevojshëm për të ruajtur funksionalitetin, stabilitetin dhe sigurinë e faqes sonë të internetit. Ne mund t'i përpunojmë gjithashtu ato për qëllime të hetimeve *forensic* në rastin e një incidenti sigurie ose për të gjeneruar statistika të përdoruesve. Për

qëllime statistikore, adresa juaj IP përdoret vetëm në formë të anonimizuar.

Baza ligjore: Neni 7(1) dh– interes i ligjshëm për ruajtjen e funksionalitetit, stabilitetit dhe sigurisë së faqes sonë të internetit.

2.6 Cookies

2.6.1 Për më tepër, kjo faqe interneti përdor cookies. Këto janë skedarë të vegjël teksti që mund të vendosen në pajisjen tuaj gjatë shfletimit të faqes sonë të internetit, të cilat ruajnë disa informacion rreth jush. Cookies nuk mund të aksesojnë, lexojnë ose modifikojnë të dhëna të tjera të ruajtura në pajisjen tuaj. Kur flasim për "cookies", përfshijmë edhe teknologji të tjera me qëllime të ngjashme, siç janë pixel tags.

2.6.2 Ne përdorim dy lloje cookies në faqen tonë të internetit:

(i) **Cookies të nevojshme:** Pa cookies të nevojshme, funksionimi i duhur i faqes sonë të internetit nuk do të ishte i mundur ose do të ishte i kufizuar. Përdorimi i cookies të nevojshme në faqen tonë të internetit është i mundur pa pëlqimin tuaj. Megjithatë, mund ta çaktivizoni cookies në çdo kohë duke modifikuar cilësimet e shfletuesit tuaj. Për një përshkrim të detajuar të cookies të nevojshme dhe qëllimeve përkatëse, ju lutemi shihni më poshtë.

(ii) **Cookies opsionale:** Këto lloje cookies mund të përdoren për të përmirësuar faqen tonë të internetit, për të optimizuar përvojën tuaj si përdorues, për të analizuar sjelljen e përdoruesit ose për të personalizuar aktivitetet e marketingut. Cookies opsionale mund të vendosen edhe nga kompani të jashtme reklamuese ("cookies të palëve të treta"). Cookies opsionale do të përdoren vetëm me pëlqimin tuaj, të cilin mund ta jepni duke klikuar "OK" në bannerin e cookies të faqes sonë të internetit. Ky pëlqim mund të tërhiqet në çdo kohë me efekt për të ardhmen. Për një përshkrim të detajuar të cookies opsionale të përdorura dhe qëllimeve përkatëse, ju lutemi shihni Seksionin 2.8 më poshtë.

Baza ligjore: Neni 7(1) a– pëlqimi

2.7 Analitika e Uebit

2.7.1 Google Analytics

Për të kuptuar më mirë se si përdoret Faqja jonë dhe çfarë përmbajtjeje duhet të zhvillojmë më tej, ne përdorim "Google Analytics" për të përpiluar statistika anonime të përdorimit. Ky mjet analize përdor "cookies" (të palëve të treta) për të mbledhur informacion standard të regjistrimit, si dhe sjelljen e vizitorëve në faqen tonë në formë të përmbledhur. Analizat e përmbledhura do të kryhen, në veçanti, mbi faktorët e mëposhtëm: Numri dhe kohëzgjatja e shikimeve të faqeve të (nën-)faqeve individuale, vendndodhja gjeografike e akseseve, pajisjet fundore të përdorura nga vizitorët (Ueb/celular), gjuha, sistemi operativ, ofruesi i shërbimit dhe rezolucioni i ekranit (në pajisjet mobile).

2.8 Si të kontrolloni dhe menaxhoni përdorimin e cookies

2.8.1 Duke klikur në butonin 'OK' në banner-in e cookies të Faqes së Internetit, ju pajtoheni me përdorimin e cookies-ve opsionale të përmendura më sipër në Faqen tonë. Pëlqimi juaj mund të tërhiqet (për të gjitha ose për cookie-t individuale) në çdo kohë, me efekt për të ardhmen.

2.8.2 Ju gjithashtu mund të refuzoni përdorimin e cookies duke zgjedhur cilësimet përkatëse në shfletuesin tuaj ose duke fshirë cookies nga pajisja dhe shfletuesi. Shumica e shfletuesve pranojnë automatikisht cookies, por mund të ndryshoni cilësimet e shfletuesit tuaj për të fshirë cookies ose për të parandaluar pranimin automatik nëse preferoni. Në përgjithësi, ju keni mundësinë të shihni cilat cookies janë vendosur dhe t'i fshini ato individualisht, të bllokoni cookies të palëve të treta ose cookies nga faqe të caktuara, të pranoni të gjitha cookies, të njoftoheni kur një cookie vendoset ose të refuzoni të gjitha cookies. Vizitoni menunë 'opsione' ose 'preferenca' në shfletuesin tuaj për të ndryshuar cilësimet, dhe kontrolloni lidhjet e mëposhtme për më shumë informacion specifik për shfletuesin tuaj:

[Cilësimet e cookies në Internet Explorer](#)

[Cilësimet e cookies në Firefox](#)

[Cilësimet e cookies në Chrome](#)

[Cilësimet e cookies në Safari](#)

2.8.3 Duhet të jeni të vetëdijshëm se çdo preferencë do të humbasë, nëse fshini të gjitha cookies dhe shumë faqe interneti nuk do të funksionojnë siç duhet ose do të humbisni disa funksionalitete. Për këto arsye ne nuk rekomandojmë që të çaktivizoni cookies gjatë përdorimit të faqes sonë të internetit.

3. KUJT MUND T'IA ZBULOJMË TË DHËNAT TUJA TË PERSONALE:

3.1 Për qëllimet e përmendura më sipër, mund të ndajmë të dhënat tuaja personale me marrësit e mëposhtëm:

- kompanitë e grupit, kur është e nevojshme për të realizuar shërbimet tona (p.sh., kur kërkon shërbime të caktuara përmes Faqes sonë të internetit);
- ofruesit e shërbimeve IT që ofrojnë shërbime hosting, mirëmbajtjeje dhe sigurie për Faqes tonë të internetit
- partnerët për reklamim dhe analizën e uebit (p.sh. Google LLC) që ofrojnë shërbime të caktuara në lidhje me Faqen tonë të internetit
- Në rastet kur zbulimi është i detyrueshëm (i) nga ligji ose rregulloret ose (ii) për të ngritur, ushtruar ose mbrojtur kërkesa ligjore, mund të zbulojmë gjithashtu të dhëna personale ndaj një autoriteti kompetent, siç janë autoritetet mbikëqyrëse, rregullatore ose penale, gjykatat ose palë të treta që na këshillojnë në këtë kontekst (p.sh. avokatët ose ekspertët)

3.2 Disa nga këta marrës mund të jenë të vendosura në shtete jashtë BE **për të cilat Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale (Komisioneri)** nuk ka vlerësuar ende një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje të të dhënave. Duhet theksuar se niveli i mbrojtjes së të dhënave në këto shtete mund të mos jetë i njëjtë me atë në BE-së dhe vendeve të tjera sipas **Vendimit të Komisionerit nr 01, datë 30.04.2025**. Gjithashtu, në përputhje me ligjet dhe rregulloret lokale, të dhënat mund të jenë të aksesueshme për autoritetet ose gjykatat lokale.

3.3 Megjithatë, kur të dhënat personale transferohen në këto shtete të treta, ne zbatojmë masa të përshtatshme mbrojtëse për të siguruar që të drejtat tuaja të jenë të mbrojtura në përputhje me Ligjin. Kjo përfshin nënshkrimin e klauzolave standarde kontraktuale të Komisionerit. Detaje të tjera mbi masat e mbrojtjes të zbatuara si dhe kopje të marrëveshjeve përkatëse janë të disponueshme sipas kërkesë në adresën info@atlantik.al

4. PËR SA KOHË I RUAJMË TË DHËNAT TUAJA PERSONALE

4.1 Dosjet e regjistrimit zakonisht mbahen për një periudhë prej 3 muajsh. Pas kësaj periudhe, dosjet e regjistrimit do të ruhen vetëm për qëllim hetimi të parregullsive ose incidenteve të sigurisë në sistemin tonë.

4.2 Në përgjithësi ne i mbajmë të dhënat tuaja personale për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin ato janë marrë. Kështu, në çdo rast ne përpunojmë të dhënat tuaja personale për kohëzgjatjes së marrëdhënies sonë kontraktuale ose shërbimore me ju. Pas kësaj periudhe, ne ruajmë të dhënat tuaja personale për të përmbushur detyrimet ligjore për ruajtjen (p.sh., për të përmbushur detyrimin 5-vjeçar të ruajtjes sipas ligjit tatimor dhe tregtar në fuqi). Kur është e nevojshme, mund të mbajmë gjithashtu të dhënat tuaja për aq kohë sa kërkesat ligjore potenciale kundër nesh nuk janë ende të parashkruara; për disa kërkesa, periudha e parashkrimit ligjor mund të zgjatet sipas kërkesave ligjore në fuqi.

4.3 Pasi të mos ekzistojnë më arsye të ligjshme për ruajtjen e mëtejshme të të dhënave personale, ato do të fshihen ose anonimizohen.

5. TË DREJTAT TUAJA SI SUBJEKT I TË DHËNAVE

5.1 Si subjekt i të dhënave, ju keni ndër të tjera të drejtat e mëposhtme sipas kushteve të përcaktuara me ligj:

- Të kontrolloni nëse dhe çfarë lloj të dhënash personale mbajmë për ju dhe të kërkonti kopje të këtyre të dhënave (e drejta për akses)
- Të kërkonti korrigjimin, plotësimin ose fshirjen e të dhënave tuaja personale që janë të pasakta ose të përpunuara në mënyrë që nuk përputhen me kërkesat e zbatueshme (e drejta për korrigjim dhe fshirje)
- Të kërkonti që të kufizojmë përpunimin e të dhënave tuaja personale (e drejta për kufizim)
- Në rrethana të caktuara, të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale për arsye legjitime ose të tërhiqni pëlqimin e dhënë më parë për përpunimin (e drejta për të kundërshtuar ose tërheqjen e pëlqimit)
- Të merrni të dhënat personale që na keni ofruar në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm nga makina dhe t'i transmetoni ato të dhëna te një kontrollues tjetër (e drejta për transportimin e të dhënave)"

5.2 Ne nuk përpunojmë të dhënat tuaja personale me qëllim marrjen e vendimeve që bazohen vetëm në përpunimin automatik, përfshirë profilizimin, i cili ka efekte ligjore që lidhen me ju (Neni 20 i Ligjit).

5.3 Për të ushtruar ndonjërin nga të drejtat e mësipërme, ju lutemi dërgoni një email në info@atlantik.al

6. PËRDITËSIME TË KËTIJ NJOFTIMI

6.1 Ne mund të përditësojmë këtë Njoftim për të reflektuar ndryshime ligjore, teknike ose të biznesit. Kur ta përditësojmë këtë Njoftim, do të marrim hapa të arsyeshëm për t'ju informuar rreth ndryshimeve të bëra. Data e 'përditësimit të fundit' do të gjendet në fillim të këtij Njoftimi.

7. KËSHILLA LIGJORE

7.1 Faqja jonë përmban lidhje me faqe të tjera interneti të palëve të treta. Ne nuk kemi asnjë kontroll mbi përmbajtjen ose praktikën e privatësisë të këtyre faqeve të tjera. Ju lutemi lexoni dispozitat përkatëse të mbrojtjes së të dhënave të faqeve të tjera që vizitoni.

8. TË DHËNAT TONA TË KONTAKTIT

8.1 Nëse keni ndonjë kërkesë apo pyetje në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale nga ana jonë, ju lutemi drejtoheni tek zyrat qendrore në adresën

Atlantik Shoqëri Sigurimesh Sh.A, Rr. Themistokli Gërmenji 3/1, Tiranë, Tel: 042223744 ose email:info@atlantik.al